

Raport lidhur me projektet zhvillimore dhe Linjën e 10-të Hekurudhore për muajin tetor dhe nëntor 2020.

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA – INFRAKOS, përveç angazhimeve tjera të përditshme në realizimin e detyrave të parapara një vëmendje të posaçme ia ka përkushtuar edhe projekteve zhvillimore të cilat janë të një rëndësie të veçantë. Projektet zhvillimore të INFRAKOS-it në ekzekutim e sipër gjatë periudhës raportuese janë:

1. Rehabilitimi gjeneral i Linjës së 10-të hekurudhore (Kufiri me Serbinë – Leshak – Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut)
2. Projekt dizajni preliminar për Linjën e 7-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Prishtinë – Podujevë – Kufiri me Serbinë)
3. Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e Linjës Hekurudhore (Prishtinë – Aeroporti i Prishtinës)

1. Rehabilitimi gjeneral i Linjës së 10-të hekurudhore (Kufiri me Serbinë – Leshak – Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut)

Rehabilitimi Gjeneral i Linjës së 10-të Hekurudhore Faza 1: (Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut)

Gjatë muajit tetor dhe nëntor është zhvilluar një numër i konsideruar i aktiviteteve rreth vazhimit të punëve për rehabilitimin e fazës së parë të Linjës së 10-të hekurudhore në disa fronte pune përgjatë kësaj linje hekurudhore. Edhe pse ka pasur punime të përditshme, megjithatë vëllimi i punëve të realizuara nuk ka qenë në nivelin e dëshiruar andaj është kërkuar angazhim shumë më i madh i kontraktorit për realizimin e punëve, ashtu që projekti të kryhet në afatin e paraparë (gusht 2021).

Punët e realizuara në këtë periudhë kohore janë kryer në stacionin Hekurudhor të Fushë Kosovës, Miradisë, Lipjanit, Ferizajt dhe në stacionin Hekurudhor të Gurzës. Vlen të përmendet se gjatë muajit tetor – nëntor Kontraktori ka bërë edhe dërgimin e materialit (pjesëve të infrastrukturës) përfshirë këtu balastin për shtrirje në binarë, traversat e betonit dhe materialit tjetër përforcues për binarët hekurudhor.

Në vijim është bërë prezantimi me fotografi i disa nga punët e kryera gjatë muajit tetor – nëntor 2020:



Pastrimi i terrenit



Pastrimi i terrenit



Deponimi i traversave në Stacionin e Miradisë



Deponimi i traversave në Stacionin e Gurzës





Deponimi i ballastit dhe marrja e mostrave për testim



Kontrollimi i gjeometrisë, profili 1 – 25,
Fushë Kosovë



Kontrollimi i gjeometrisë në
profilet 548 – 566 në Hashanaj



Kontrollimi i gjeometrisë për pjesën e
gërmimit në Stacionin e Ferizajt



Matja e vëllimit të deponive të ballastit në
Stacionin e Miradisë



Inçizimi i gjendjes zero (gjendjes aktuale të terrenit) në pjesën e qytetit të Lipjanit



Punimet në linjën kryesore St. 257+700 – 258+180 afër ndalesës në Hashanaj



Përfundimi dhe testimi i shtresës mbrojtëse të binarit



Gërmimi në Nakarade



Ngjeshja dhe përgaditja e fondimit në Nakarade



Ri-gërmimi si rezultat i kualitetit të dobët të tokës dhe vendosja dhe testimi i shtresës përmirësuese



Shtresa e përmirësuar në Nakarade

Testimi i shtresës mbrojtëse



Gërmimi shtesë në profilet 208 – 214 në Miradi

Shtresë e përmirësuar nga ballasti ekzistues CS. 208-214 në Miradi




Punimet në linjat 1 dhe 2 në Stacionin e Ferizajit St. 281+200 – 281+920



Ngjeshja e shtresës përmirësuese në Stacionin e Ferizajit




Vendosja e traversave në Hashanaj



Vendosja e shinave në Hashanaj



Binarët e ri në Hashanaj



Binarët e ri në Hashanaj



Ndërtimi i lëshesave



Ndërtimi i lëshesave



Vendosja e gjeotekstilit



Vendosja e gypave të drenazhes



Armatura për pllaka dhe mure në stacionin hekurudhor të Miradisë



Ndërtimi i Gypave kalues SN8, Miradi



Ndërtimi i murit mbrojtës në Miradi



Ndërtimi i parapetit dhe rampave



Ndërtimi i platformës në Lipjan



Ndërtimi i platformës në Lipjan



Ndërtimi i platformës në Hashanaj



Platforma e përfunduar në Hashanaj



Lyerja e shtresës së betonuar

Lyerja e shtresës së betonuar

Gërmimi pranë kablllove optike

Rivendosja e kablllove optike

Rehabilitimi Gjeneral i Linjës së 10-të Hekurudhore Faza 2: (Fushë Kosovë – Mitrovicë)

Komisioni vlerësues mbi bazën dhe instruksionet e kompanisë mbështetëse të Njesisë për Implementimin e Projekteve dhe të procedurave të përcaktuara nga BERZH-i dhe BEI për procesin e vlerësimit edhe gjatë muajit tetor dhe nëntor ka vazhduar punën dhe është në vazhden e vlerësimit të ofertave për përzgjedhjen e kompanisë punëkryese. Procesi po shkon me dinamikën e planifikuar, kushtet në të cilat po punon komisioni janë shumë të mira, ndërsa gjatë tërë kohës komisioni mbështetet edhe nga kompania konsulente Egis International e cila me ekspertizën e saj e mbështetë komisionin vlerësues. Në fillim të muajit dhjetor pritet që të bëhet përzgjedhja e kompanisë fituese dhe raporti i vlerësimit t'i dërgohet BERZH-it për rishikim.

Po ashtu gjatë këtyre dy muajve komisioni i veçantë vlerësues e ka bërë vlerësimin e ofertave për tenderin me titull Rehabilitimi i Linjës së 10-të Hekurudhore: Shërbimet e konsulencës për mbikëqyrjen e ndërtimit të rehabilitimit të fazës II të Linjës së 10-të Hekurudhore (Seksioni: Fushë Kosovë – Mitrovicë). Komisioni e ka hartuar listën e kompanive të cilat i plotësojnë kriteret për vazhdimin e konkurrimit. Pas dërgimit të raportit tek BERZH-i dhe BEI-ja për rishikim, atëherë pritet që të dërgohet kërkesa për ofertat teknike dhe financiare ashtu që më pastaj të fillon edhe procedura e vlerësimit deri në përzgjedhjen e kompanisë mbikëqyrëse për këtë fazë. Ky komision vlerësues po ashtu është duke punuar sipas procedurave të BERZH-it dhe BEI-së dhe i

mbështetur nga këshillat e kompanisë konsulente Egis International e cila me ekspertizën e saj e mbështetë komisionin vlerësues.

Rehabilitimi Gjeneral i Linjës së 10-të Hekurudhore Faza 3: (Mitrovicë – Leshak – Kufiri me Serbinë)

Gjatë këtyre dy muajve ka vazhduar puna intensive me IFICO-n për hartimin e Termave të Referencës për hartimin e Projekt Dizajnit të fazës së III (Mitrovicë - Leshak). Ekspertët e IFICO-s dhe ata të INFRAKOS-it i kanë përfunduar Termat e Referencës për projekt dizajnin detaj teknik të rehabilitimit të fazës së tretë të Linjës së 10-të Hekurudhore. IFICO tanimë ia ka dërguar termat e referencës Konzorciumit IPF 9 – Hill International të cilët janë të angazhuar nga WBIF për hartimin e projekt dizajnit, kështu që sipas të gjitha parashikimeve dhe përgatitjeve paraprake ky projekt dizajn do të fillon në muajin shkurt të vitit 2021.

Projekt dizajni për sinjalizim dhe telekomunikacion për Linjën e 10-të Hekurudhore Faza (1+2): (Hani i Elezit – Fushë Kosovë - Mitrovicë)

Projekt dizajni për rehabilitimin e pajisjeve sinjalo siguruese dhe ato të telekomunikacionit për fazën e parë dhe të dytë të Linjës së 10-të hekurudhore është në fazën finale. Janë duke u bërë modifikimet e fundit nga ekipi i ekspertëve dhe kompania projektuese.

Në momentin që kjo të kryhet, INFRAKOS-i në bashkëpunim me BERZH-in dhe BEI-në do të bënë publikimin e shprehjes së interesit për përzgjedhjen e kompanisë punëkryese e cila do të bënë rehabilitimin e pajisjeve SS dhe TK.

Në të njëjtën kohë në bashkëpunim me kompaninë konsulente janë duke u hartuar Termat e Referencës për publikimin e shprehjes së interesit për përzgjedhjen e kompanisë mbikëqyrëse për sinjalizim dhe telekom për fazën (1+2).

2. Projekt dizajni preliminar për Linjën e 7-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Prishtinë – Podujevë – Kufiri me Serbinë)

Në krahasim me raportin e muajit Shtator 2020, gjatë muajit tetor – nëntor ka pasur angazhim të theksuar të Konzorciumit IPF 7 – Hill International për hartimin e dokumentit final të projekt dizajnit preliminar për Rehabilitimin Gjeneral të Linjës së 7-të Hekurudhore. Gjatë këtij muaji ka pasur komunikime për çështje të ndryshme me kompaninë projektuese dhe ashtu siç është thënë më herët pritet që ky projekt dizajn preliminar të përfundojë deri kah fundi i muaji mars i vitit vijues.

3. Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e Linjës Hekurudhore (Prishtinë – Aeroporti i Prishtinës)

Njëri ndër projektet e infrastrukturës hekurudhore i cili po ashtu financohet nga grantet e Kornizës Investive të Ballkanit Perëndimor (WBIF) është edhe studimi i fizibilitetit për ndërtimin e linjës hekurudhore (Prishtinë – Fushë Kosovë – Aeroporti i Prishtinës), projekt ky i cili është i një rëndësie të veçantë për lidhjen e aeroportit me hekurudhë.

Gjatë muajit Tetor – nëntor kompania e angazhuar për hartimin e studimit të fizibilitetit (Konzorciumi HILL International IPF 7) në bashkëpunim me ekspertët e INFRAKOS-it kanë punuar në finalizimin e opsionit më të mirë për ndërtimin e kësaj linje hekurudhore ashtu që më pastaj të bëhet drafti final i këtij dokumenti.